

VENDIM
Nr.881, datë 3.11.2010

**PËR CAKTIMIN E ZONAVE TË VENDOSJES SË ANTENAVE TË KOMUNIKIMIT
DHE TË ATYRE RADIO-TELEVIZIVE NË PARKUN KOMBËTAR “MALI I DAJTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e vendeve për vendosjen e antenave të komunikimit dhe të atyre radio-televizive në territorin e parkut kombëtar “Mali i Dajtit”, në zonat si më poshtë vijon:

a) Blloku “1”, në majën e malit të Tujanit (1531 m), me sipërfaqe 300 (treqind) m² dhe me koordinata 44 09 279L dhe 45 83 149V.

b) Blloku “2”, në majën e malit të Dajtit (1613 m), me sipërfaqe 1200 (një mijë e dyqind) m² dhe me koordinata 44 10 033L dhe 45 82 079V.

c) Blloku “3”, në majën e malit të Derjes (1308 m), me sipërfaqe 600 (gjashtëqind) m² dhe me koordinata 44 17 538L dhe 45 79 068V.

ç) Blloku “4”, pranë qendrës së vizitorëve të parkut kombëtar, në kryqëzimin e rrugës që të çon te rezidencat qeveritare dhe në sheshin kryesor të parkut, me sipërfaqe 4960 (katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) m² dhe me këto koordinata:

Pika 1, 44 09 048L dhe 45 81 218V;

Pika 2, 44 09 024L dhe 45 81 216V;

Pika 3, 44 09 055L dhe 45 81 177V;

Pika 4, 44 09 109L dhe 45 81 149V;

Pika 5, 44 09 135L dhe 45 81 149V;

Pika 6, 44 09 160L dhe 45 81 119V;

Pika 7, 44 09 180L dhe 45 81 168V;

Pika 8, 44 09 111L dhe 45 81 187V;

Pika 9, 44 09 081L dhe 45 81 193V.

d) Blloku “5”, pranë qendrës së vizitorëve të parkut kombëtar, në kryqëzimin e rrugës që të çon te rezidencat qeveritare, me sipërfaqe 640 (gjashtëqind e dyzet) m² dhe me këto koordinata:

Pika 1, 44 09 336L dhe 45 81 277V;

Pika 2, 44 09 325L dhe 45 81 288V;

Pika 3, 44 09 342L dhe 45 81 303V;

Pika 4, 44 09 361L dhe 45 81 282V;

Pika 5, 44 09 348L dhe 45 81 267V.

dh) Blloku “6”, pranë qendrës së vizitorëve të parkut kombëtar, në kryqëzimin e rrugës që të çon te rezidencat qeveritare, me sipërfaqe 560 (pesëqind e gjashtëdhjetë) m² dhe me këto koordinata:

Pika 1, 44 09 207L dhe 45 81 368V;

Pika 2, 44 09 208L dhe 45 81 386V;

Pika 3, 44 09 226L dhe 45 81 383V;

Pika 4, 44 09 226L dhe 45 81 370V;

Pika 5, 44 09 215L dhe 45 81 353V.

e) Blloku “7”, sipër depos së ujit, me sipërfaqe 100 (njëqind) m² dhe me koordinata 44 09 514L dhe 45 80 350V.

2. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nëpërmjet strukturave të saj të varësisë, evidenton sipërfaqet që përdoren aktualisht nga operatorët e komunikimit dhe ata radio-televizivë, si dhe shlyerjen detyrimeve kontraktore. Për operatorët që kanë nënshkruar kontrata me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Tiranë, zbatimi i tyre do të vijojë deri në përfundimin e afateve të nënshkruara. Rinovimi i kontratave të kryhet vetëm pas vlerësimit të zbatimit të ligjshmërisë dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nëpërmjet strukturave të saj të varësisë, për të gjitha subjektet që disponojnë antena të komunikimit dhe ato radio-televizive, por që nuk kanë leje ndërtimore, të miratuar nga KRRTRSH-ja e në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, pezullon kontratat dhe kryerjen e veprimtarisë, deri në vlerësimin dhe plotësimin e detyrimeve ligjore, brenda një afati kohor 1-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Në blloqet e caktuara për vendosjen e antenave të komunikimit dhe atyre radio-televizive, në territorin e parkut kombëtar “Mali i Dajtit”, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, marrëdhëniet për shërbimet dhe nënshkrimi i kontratave për sipërfaqet e dhëna në përdorim për secilin operator, kryhen vetëm me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, dhe të Kodit Civil.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha